




Majlinda Baliaj  
Ryfi



Albete Bushonj  
Dr  
Maida Monopoli T'hej



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
SENATI AKADEMIK

Nr. 2536 Prot.

110

Vlorë më, 06.11.2024

VENDIM

Nr. 59, datë 06.11.2024

PËR

HAPJEN E PROGRAMIT TË RI PROFESIONAL DY VJECAR TË STUDIMIT,  
"ASISTENT I LARTË LIGJOR" PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026 NË  
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 25, pika 7, 38, pika 1, shkronja dh, nenit 71, 72, të ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 10, pika 6, nenit 19, pika 1, shkronja ë, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1 të MAS datë 14.01.2020, "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL-ve, degëve dhe njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL-ve", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar, si dhe referuar propozimit të Departamentit e Drejtësisë, si dhe relacionit të Zëvendësrektorit Akademik, përcjellë me shkresën 2428/3, prot, datë, 05.11.2024, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.11.2024,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin e Departamentit të Drejtësisë, në Fakultetin e Shkencave Humane, për hapjen e programit të ri profesional dy vjecar "Asistent i lartë ligjor", sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit Akademik, Drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Humane, si dhe Drejtoria e Edukimit e Ciklit të Parë dhe të Dytë të studimit.
3. Ky vendim i përcillet për miratim të mëtejshëm Bordit të Administrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

A Saliaj

